

“ISHA BULLIZUES”

i Andrea Franzosos

SKEDA 6

KAPITULLI 16-17-18-19



“Çdokush rritet vetem nese enderrohet”

Një ditë, Anxhela arrin “ta shtangë Danielin”: kur e thërrasin, ai pret një ndëshkim dhe në vend të kësaj ai merr një shpërblim. Për çfarë bëhet fjalë? Pse është një shpërblim?

Me çfarë krahasimi përshkruhet skuadra e Mirëmbajtjes së Zakonshme të Ndërtesave? Ishte si një ishull...

“Po sikur dikush të vritet? Kush e merr përgjegjësinë për të?”. Si u përgjigjet Brigadier Stara këtyre pyetjeve? Çfarë mendon ti?

“Çdokush rritet vetëm nëse ëndërrohet” është një varg nga poeti Danilo Dolçi, i cili qe edhe një mbështetës i jo-dhunës. Çfarë do të thotë kjo fjali në lidhje me këtë moment të historisë së Danielit? Kush e ëndërroi atë?

Fjalët janë të rëndësishme

1. “Në skuadrën tonë nuk ka ‘unë’, ‘unë’, ‘unë’. Ka vetëm ‘ne’”, thotë Brigadier Stara. Cilat nga këto shprehje kanë të njëjtin kuptim? Nuk ka dy pa tre. Më mirë vetëm, sesa i keqshoqëruar. Të gjithë për një, një për të gjithë.

2. “Danieli vazhdoi ta vuante ‘personazhin’ e tij për një kohë të gjatë”: në këtë rast fjala “personazh” është e kundërta e fjalës “person”. Personi është djali me emrin Daniel, prej mishi e gjaku; kush është “personazhi Daniel”?

Përcaktimi i ndjenjave

1. OBSESION/FIKSIM: një mendim që nuk të shqitet nga mendja dhe që të mundon. Jep një shembull obsesioni.

2. LUMTURI: Pak nga pak, ideja e Danielit për lumturinë ndryshon plotësisht. “Vetëm në atë moment Danieli e kuptoi se kishte humbur shumë vite prej jetës së tij duke ndjekur dukjen, duke kërkuar arritje kalimtare që nuk sillnin asnjë gëzim”. A mund të japësh ndonjë shembull të këtyre fitoreve “jetëshkurtra”?

Kush është një njeri i lumtur? Ku po e kërkon Danieli lumturinë tani? Po ti, ku e kërkon lumturinë?

REFLEKTIM PERSONAL:

E GJEJ SE KUSH JAM

Përgatitni shirita kartoni të bardhë rreth 50 cm të gjatë, një për secilin lojtar. Shpërndajini ato. Ndahuni në tre grupe, të cilat do të luajnë veçmas. Në secilin grup, një lojtar shkruan emrin e një personazhi nga “Isha bullizues” në shirit dhe e vendos atë në kokën e lojtarit tjetër si një kurorë. Pastaj vazhdon i dyti, i treti (më mirë mos e bëni të gjithë bashkë për të shmangur zgjedhjen e një personazhi prej më shumë se një personi). Çdo lojtar nuk e di se kush është (domethënë, cili është emri në kurorën në kokën e tij) dhe duhet ta zbulojë duke u bërë pyetje të tjerëve. Pyetjeve mund t’u jepet përgjigje vetëm me po ose jo.

DEBAT: VENDOS TI: një përgjigje që të shtang

Kur Danieli i kërkon Dom Klaudios leje për t’u kthyer më vonë në komunitet, ai i përgjigjet: “Vendos ti”. Edukatori nuk ndalon asgjë, por i shtyn djemtë që të marrin një vendim, duke marrë përsipër përgjegjësitë e tyre. Sipas mendimit tënd, a është kjo përgjigje më shumë apo më pak e vlefshme, sesa një PO ose një JO? Pse? Si ndihet ai të cilit i jepet kjo përgjigje? Flitni për këtë gjë në klasë.

NDJENJA:

BESIMI

Jeta e Danielit fillon të ndryshojë në momentin që dikush i beson. Ishte pikërisht ajo që i nevojitej.

Për herë të parë, në skuadrën e Brigadier Starës, Danieli **ndihet i vlerësuar për aftësitë e tij, i çmuar**. Rishikoje historinë e tij para burgut: në fakt, askush nuk e kishte bërë ndonjëherë të ndihet i zoti, i aftë. Kush, më shumë se kushdo tjetër, e ka këtë përgjegjësi? Jep të paktën një shembull.

Në Kajros, krejt jeta e komunitetit bazohet në besim, i cili pasqyrohet edhe në gjëra. Çfarë domethënie kanë, për shembull, **dyert gjithmonë të hapura**?

Në fletoren tënde, trego një episod nga jeta jote që tregon se nëse i beson një personi, ai jep më të mirën e tij. Mendoni për shembull për sportin, shkollën, familjen...

Të rriturit: EDUKATORËT

ANXHELA e ka zemrën të copëtuar, sepse sapo kishte humbur të atin. Por kjo nuk e pengon atë të bëjë një zgjedhje të guximshme: të besojë te Danieli. Në fakt, Anxhela është e bindur se tek çdo djalë, madje edhe tek "më i keqi"...

BRIGADIER STARA: ai përshkruhet si një person i saktë, i qetë dhe që bënte atë që thoshte. Çfarë ndjesish përcjell ky personazh? Çfarë pa Danieli tek ai dhe pse u lidh me të? Nëse do të duhej ta krahasojë me një anëtar të familjes, a do ta identifikojë me një baba, me një gjysh apo me një xhaxha?

Pak nga pak, një e vërtetë e madhe del në dritë: të rriturit e vetëm që arrijnë të marrin diçka nga Danieli nuk janë ata që imponohen (autoritarë), por ata që bindin, sepse janë të besueshëm (ose me autoritet). Po ti, si mendon?

MËNJANIMI, PËRFSHIRJA DHE RACIZMI

Kur arrin në burgun e Katantias, Danieli ndihet si i huaj. Të gjithë flasin me njëri-tjetrin në dialekt dhe ai nuk kupton se çfarë thonë; një situatë që e bëri të kujtonte mënyrën se si i trajtonte emigrantët në Bekaria: "...që atëherë i premtoi vetes se do të ndryshonte qëndrim ndaj të gjithë atyre që i konsideronin 'inferiorë', veçanërisht romëve". E njëjta gjë, për fat të keq, ndodh edhe në shoqërinë tonë, ende ka mosbesim ndaj atyre që janë të ndryshëm (për çfarëdo arsyeje, nga ngjyra e lëkurës te feja e te idetë): për shembull, për emigrantët është e vështirë të integrohen. Kemi ende rrugë të gjatë për të zhdukur racizmin dhe paragjykimet gjinore (pabarazinë burrë-grua), në mënyrë që të mos ndihemi të gjykuar për orientimin tonë seksual. Diversiteti është pasuri.

1. Në Katania, një djalë bën sikur është shurdhmemec për një javë për t'u tallur me Danielin. Ky është një episod bullizmi; por këtë herë nuk është e njëjta situatë me atë që ndodhte në shkollën nëntëvjeçare. Cili është roli i Danielit në të dyja situatat?

2. Pastaj Danieli përjeton vlerën e solidaritetit. Si e përcakton atë? Çfarë shembujsh jep për të ilustruar këtë vlerë?

3. Në ç'kuptim diversiteti është një pasuri? Njerëzit që vijnë nga një vend i ndryshëm nga i yni me siguri kanë mësuar gjëra që ne nuk i dimë, dhe ne mund t'i bashkëndajmë ato. Jep ndonjë shembull, duke u nisur nga një temë e thjeshtë, si gatimi.